



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuhë B e folur dhe e shkruar (1+2)

Ngarkesa: 4 kreditë, 40 seminare
Viti / Semestri: Viti I, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në ‘‘Përkthim dhe Interpretim në gjuhë ruse’’
Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT :

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të zhvillojë më tej shprehitë e fituara në modulit e parë të gjuhës së folur dhe të shkruar. Të përmirësojë aftësitë e komunikimit dhe të përgatitë studentin për përvetësimin e lëndëve të mëtejshme gjuhësore. Të pasurojë fjalorin dhe shprehitë gjuhësore për përshkrimin e dukurive të ndryshme që e rrethojnë. Të edukojë aftësinë për të analizuar, krahasuar dhe nxjerrë përfundime logjike përmes mendimit kritik dhe analitik.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të ndihmojë studentin të emërtojë dhe karakterizojë objekte dhe dukuri të ndryshme dhe t'i diferencojë ato.
2. Të nxisë pjesëmarrjen aktive në dialog dhe në biseda spontane në gjuhën ruse.
3. Të aftësojë studentin të shprehet për tema të caktuara përmes ndërtimit të një tregimi logjik me bazë personale.
4. Të përvetësojë në mënyrë të vetëdijshme shprehitë përmes punës me dialogë, ushtrime dhe tekste autentike, si bazë për ndërtimin e teksteve të veta.

Rezultatet e pritshme.:

1. Studentët do të jenë në gjendje të përdorin në mënyrë të zgjeruar fjalorin dhe strukturat gjuhësore të mësuara për të komunikuar në situata të ndryshme.
2. Do të përvetësojnë aftësinë për të analizuar dhe interpretuar tekste leksiko-gramatikore me përmbajtje kulturore.
3. Do të jenë të aftë të ndërtojnë tekste të thjeshta të shkruara dhe të folura mbi tema të caktuara në mënyrë koherente dhe të organizuar.
4. Do të zotërojnë kompetenca komunikuese që u mundësojnë të marrin pjesë aktive në diskutime dhe biseda në gjuhën ruse.